



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.88/2025

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Yenilikci Turk Hareket Partisi, YTHP, me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi, KDTP, me seli në Prizren, shpërndarja ose shfaqja e çfardo lloj materjali në ndonjë QV në afërsi prej 100 m, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 03.10.2025, merr këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET E PABAZUAR**, ankesa e subjektit politik Yenilikci Turk Hareket Partisi, YTHP, me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi, KDTP, me seli në Prizren, shpërndarja ose shfaqja e çfardo lloj materjali në ndonjë QV në afërsi prej 100 m, në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025,

### A r s y e t i m

Me datë 01.10.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Yenilikci Turk Hareket Partisi - YTHP, me seli në Prizren, në të cilën thekson se, Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), me seli në Prizren, shfrytëzon një zyrë përballë Shkollës Filllore "Motrat Qiriazhi" (Qendrës së Votimit), dhe kjo zyrë aktivizohet vetëm gjatë periudhës së fushatës dhe posaçërisht në ditën e zgjedhjeve. Ky fakt është i konfirmuar edhe nga vetë kryetari i subjektit politik KDTP, njëkohësisht ministër në detyrë, z. Fikrim Damka, i cili më datë 29.09.2025, në një takim me qytetarë, publikisht ka deklaruar: *"Logoja e partisë do të jetë e hapur në këtë zyrë; më 12 tetor vetëm pesëmbëdhjetë minuta do të ndani, do të vini në zyrë, do të pini çaj dhe pastaj do të shkojmë të votojmë"*. Distanca ndërmjet kësaj zyre dhe hyrjes së qendrës së votimit është rreth 45 metra. Ky veprim përbën shkelje të qartë të Rregullores nr. 07/2024, neni 7, paragrafi 2, pika 9, ku përcaktohet ndalesa për shfrytëzimin e hapësirave për fushatë *"brenda qendrave të votimit ose në një largësi prej më pak se njëqind (100) metra nga hyrja e tyre"*. Në çdo cikël zgjedhor, kjo zyrë mbahet e hapur ditën e zgjedhjeve nga ora 07:00 deri në 19:00, duke u shëndruar në një vend grumbullimi për drejtues, kandidatë dhe persona të tjerë të subjektit politik, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt mbi vullnetin e votuesve. Kryetari Damka, madje i ka ftuar qytetarët që të shkojnë fillimisht në këtë zyrë, të takohen aty, të pijnë çaj e më pas të shkojnë të votojnë. Një veprim i tillë bie ndesh edhe me Rregulloren m. 07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e saj dhe deklarimin financiar, konkretisht Nenin 8 mbi veprimet e ndaluara gjatë heshtjes zgjedhore. Për më tepër, në të njëjtin kontekst, z. Damka ka vazhduar me deklarata kërcënuese duke thënë: *"Kjo zyrë është hapur për të gjithë, kjo zyrë do të jetë e hapur dhe askush nuk ka fuqi ta mbyllë këtë zyrë, askush nuk ka fuqi ta mbyllë zyrën e KDTP-së në lagjen Kurrilë."* Këto deklarata dhe shprehje me karakter kërcënues ndikojnë drejtpërdrejt mbi zgjedhësit, ushtrojnë presion mbi vullnetin e tyre të lirë dhe, duke qenë të artikuluara nga një kryetar partie dhe një ministër, cenojnë integritetin e procesit zgjedhor dhe

ndikojnë negativisht në institucionet publike. Prandaj, kërkojmë PZAP, që të pranoj ankesën si të bazuar dhe të ndërmerr masa ndëshkuese ndaj subjektit politik KDTP, në përputhje me dispozitat ligjore.

Si provë ka bashkëngjitur flash disk: Video nr. 1, inçizimi RTK LIVE - pjesa pare, Video nr.1, inçizimi RTK LIVE - pjesa e dyte dhe Video nr. 2, inçizimi RTK LIVE, si dhe fotografi – skice të shkollës dhe zyrës.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi – KDTP, theksohet se, pretendimet e ankesës janë të pasakta, sepse zyra në fjalë është një nga zyrat administrative të Partisë dhe përdoret vazhdimisht për shumë aktivitetet të ndryshme. Po ashtu, ashtu siç pretendohet nuk është zyre jozyrtare, sepse që nga vitit 2019, Partia Demokratike Turke të Kosovës (KDTP) është palë i kontratës si qiramarrëse. Pretendimet lidhur me fjalimet e kryetarit z.Fikrim Damka, është e qartë se ekziston një përpjekje e qëllimshme për të shtrembëruar dhe interpretuar në mënyrë të gabuar fjalët e përdorura nga kryetari ynë në fjalimet e tij publike, të mbajtura në cilësinë e funksionit të tij zyrtar. Këto fjalë, të nxjerra jashtë kontekstit dhe të kombinuara në mënyrë artificiale, po paraqiten në formën e një ankese të pabazë, duke u përpjekur të krijohet një perceptim se kemi të bëjmë me deklarata të paligjshme. Meqenëse zyra në fjale është funksionale dhe e hapur vazhdimisht, gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm në periudha zgjedhore, çdo përpjekje për të krijuar përshtypjen se ajo përdoret ekskluzivisht në ditët e zgjedhjeve përbën një shtrembërim të qëllimshëm të realitetit. Një interpretim i tillë jo vetëm që është i gabuar, por edhe synon të deformojë perceptimin publik lidhur me funksionin dhe natyrën e punës së zyrës. Është e rëndësishme të theksohet se, pavarësisht përpjekjeve të përsëritura për ta paraqitur këtë zyrë si të përfshirë në aktivitete të paligjshme, deri më sot nuk ka ekzistuar asnjë fakt apo provë konkrete që të dëshmojë ndonjë shkelje apo parregullsi në asnjë proces zgjedhor. Është krejtësisht e paqartë dhe e pambështetur se kë ka kërcënuar Kryetari i Partisë, z. Fikrim Damka, apo në çfarë mënyre është realizuar një kërcënim i tillë. Po ashtu, mbetet e pasqaruar se cilat janë saktësisht deklaratat e tij që pretendohet të jenë të paligjshme dhe mbi ç' baza ligjore është ngritur një pretendim i tillë.

Si provë ka bashkëngjitur kontratat mbi qiradhënien mbi zyrën e KDTP për disa viteve me radhë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

**- Ankesa është e pabazuar**

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që paraqitësi i ankesës nuk ka bashkëngjitur provë si dëshmi, dhe si e tillë nuk mund të vërtetohet se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike Turke të Kosovës (KDTP) ka ndodhur shkelja e pretenduar, përkatësisht me provat e bashkëngjitura nuk është argumentuar në mënyrë të qarte dhe bindës se është shkelur Rregullorja nr. 07/2024, neni 7, paragrafi 2, pika 9, ku përcaktohet ndalesa për shfrytëzimin e hapësirave për fushatë "*brenda qendrave të votimit ose në një largësi prej më pak se njëqind (100) metra nga hyrja e tyre*". Bazuar në provat e bashkëngjitur në përgjigje në ankesë, zyra e cekur në ankesë është zyre e subjektit politik Yenilikçi Turk Hareket Partisi, YTHP e cila shfrytëzohet gjatë tërë vitit dhe provat e bashkëngjitura nuk dëshmojnë se i njëjtit nuk ka bërë ndonjë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024. Pretendimet e ankesës se z. Fikrim Damka, kryetar i subjektit politik KDTP, ka ka kërcënuar apo bërë presion mbi votuesit nuk është dëshmuar me asnjë provë dhe nuk ka mbështetje juridike apo faktitke. Pretendimi se është shkelur neni 8 i Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 mbi veprimet e ndaluara gjatë heshtjes zgjedhore, nuk mund të vërtetohen pasi që

të njëjtat veprim ndalohen të ndërmerren në ditën e votimit dhe shkelja e pretenduar ende nuk ka ndodhur.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
ZL.Anr.88/2025, datë: 03.10.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.